

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 9644 REP. 688 KOL.



KONTRATE E SHITBLERJES (KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR)

Ne Tirane, sot me date 10.08.2004, para meje noter Agim Xh. Robo, me zyre noterie ne Tirane, rruga Ismail Qemali, Pall. 2771, u paraqiten personalisht, palet kontraktuese me cilesite e meposhteme:

SHITESI: Z. Mina Kosta Kota, lindur ne Korçe, me 13.11.1934, banues ne Korçe, n. pasaporte Z0280934,

BLERESI: Shoqeria "EGNATIA GROUP" sh.a, person juridik me vendim nr.28285 date 23.09.2002, perfaqesuar nga Drejtori i saj zoti Besnik Duka, biri Mithatit, dl10.11.1955, banues ne Tirane, dokumenti nr.Z0598794

Te dy me zotesi te plote juridike e per te vepruar qe me vullnetin e tyre te lire kerkuan redaktimin e aktit noterial te shitjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "**BIRRA KORCA**"sh.p.k.

Me vendim gjyqesor nr.1571 date 11.02.1994 ne Regjistrin Tregetar prane gjykates se shkalles se pare Tirane ,eshte regjistruar si person juridik shoqeria "**BIRRA KORCA**"sh.p.k. Objekti veprimtarise, kohezgjatja, kapitali themeltar, Ortaket, (gjithesej 11) dhe pjeset takuese te tyre ne kapitalin themeltar perkatesisht 1/11 pjese, percaktohen shprehimisht ne statutin dhe akt themelimin e saj.

Me vendim nr. 11 date 17.06.2004, Asambleja e Ortakeve ne perputhje me kompetencat sipas ligjit 7638 date 19.11.1992 ka vendosur: Miratimin e transferimit nepermjet shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar sipas kuotave zoteruese te Ortakeve tek subjekti tregetar "**EGNATIA GROUP**" sh.a. Ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "**Per Shoqerite Tregetare**", hartohet kontrata noteriale e shitjes.

PERMBAJTJA E KONTRATES:

SHITESI:

Ortaku Mina Kota eshte zoterues ne 1/11, ose 9.1 % pjese te kuotave te kapitalit themeltar.

Ai ia shet ato teresisht **BLERESIT** "EGNATIA GROUP" sh.a. me vlere totale te shitjes 300.000 (treqint mije) EURO

BLERESI:

"EGNATIA GROUP" sh.a. pranon blerjen e kuotave (pjese) takuese prej 1/11 ose 9.1 % ne kapitalin themeltar te shitur nga z. Mina Kota me vlere totale te shitjes 300.000 (treqint mije) EURO.

Shlyerja e vleftes se kuotave (pjeseve) te shitura behet si vijon:

Kesti i pare prej 10.000 (dhjete mije) EURO, shlyhet ne dore nga bleresi tek shitesi sot ne diten e nenshkrimit dhe vertetimit te kesaj kontrate para meje noterit.

Kesti i dyte dhe perfundimtar, (diference e mbetur), ne shumen prej 290.000 (dyqint e nentedhjete mije) EURO, do te shlyhet ne dore nga bleresi tek shitesi brenda tre muajve nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Per shlyerjen e vleftes, diference e mbetur sipas paragrafit te mesiperme, bleresi do te nenshkruaje deklarate para noterit duke garantuar bleresin se ka marre shumen e mesiperme prej tij.

Palet kontraktuese deklarojne se jane dakort me menyren e likuidimit te vleres se shitjes parashikuar si me lart.

PALA SHITESE me nenshkrimin e kesaj kontrate i njeh pales bleresese te drejten e zoterimit ne 1/11 pjese, ose 9.1% te kuotave ne kapitalin themeltar ne shoqerine « BIRRA KORCA » sh.p.k.

PALA BLERESE njeh detyrimin te shlyeje perfundimisht vleften totale brenda afatit tremujor te percaktuar me lart. Ne rast te kundert, pala shitesese rifiton te drejten e zoterimit ne kuotat (pjeset) prej 1/11 ose 9.1% ne kapitalin themeltar te blera prej pales bleresese ne kete kontrate, si dhe te

drejten e mbajtjes se pageses se kryer si kest i pare prej 10.000 (dhjete mije) EURO.

PALA SHITËSE njeh detyrimin te respektojë kushtet e kesaj kontrate ne lidhje me vleren, diference te papaguar sipas marreveshjes ne kete kontrate. Pas nenshkrimit te saj, nga pala shitese per asnje shkak nuk do te diskutohet vlefte totale e shitjes se pjeseve prej 1/11, ose 9.1%.te kuotave

PALA SHITËSE z. Mina Kota, humbet cilesine e Ortakut ne shoqerine « BIRRA KORCA » duke u larguar prej kesaj shoqerie.

PALA BLERËSE, fiton cilesine e Ortakut ne kete shoqeri.

Sa me siper kontrata e shitblerjes u redaktua ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", nenit 39 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine". Kontrata iu lexohet paleve me ze te larte.


Palet kontraktuese deklarojne se e kuptojne permbajtjen e saj dhe nenshkruajne ne fund pa asnje verejtje.

Ky akt hartohet ne tre faqe te lidhura, ne kater ekzemplare me fuqi ligjore te barabarte. Njeri prej tyre depozitohet ne kete zyre noterie, tre te tjerat u dorezohen perkatesisht njeri pales shiteses, dy te tjerat pales blereses per kryerjen e veprimeve prane Regjistrimit Tregetar.

Une noteri qe redaktova kontraten e shitblerjes ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe pasi e gjej aktin ne pajtim me ligjin, nenshkruaj dhe vertetoj rregullisht.

PALET


SHITESI
Mina Kota

Mina Kota




BLERESI
Shoqeria

"EGNATIA GROUP" SH.A.
perfaqesuar nga Drejtori

Besnik Juka


NOTER

A. Juka

